Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen me letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/paluajtshme apo të drejta reale). Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë do të jetë z.Klaus Çiraku i emëruar në këtë detyrë për një afat kohor 5-vjeçar me të drejtë ripërtëritje.
Shoqëria do të rregullohet përveç këtij Akt Themelimi edhe me norma të përcaktuara në një statut, i cili do të nënshkruhet nga të dy ortakët themelues dhe si i tillë do të fitojë personalitetin juridik me rregjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në bazë të ligjit 9723dt.03/05/2007 "Për Qëndrën Kombëtare të biznesit" i ndryshuar, ditën kur shoqëria do të legalizohet si person Juridik shqiptar.

**ORTAKËT E SHOQËRISË**
**"OMNI POWER"SHPK**

**Klaus Çiraku** | **Eljana Velaj**

**AKT THEMELIMI I**

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**Omni Power SH.P.K.**

Sot me dt..19.12.........2023, Ne themeluesit,

- **Klaus ÇIRAKU**, atësia Agim, amësia Anila, i dtl.07.09.1990, lindur dhe banues në Tiranë, në adresë Rr. "Abdyl Frashëri" ,ndërtesa 8, Ap.31, shtetas shqiptar, gjendja civile "i martuar" madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr.033525039 me nr. Personal J00907043I
- **Eljana Velaj, atësia** Hamdi, amësia Engjellushe, i dtl. 10/02/1991, lindur në Fier dhe banuese në Vlore, Lagja "Pavaresia", Rruga "Çameria",Pall "Cobo Center", shtetase shqiptare, gjendja civile "e martuar", madhore e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse i letërnjoftimit ID nr.034583615, me nr personal J15210109Q

Kemi hartuar këtë akt themelimi per krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të cilën kemi vendosur ta themelojmë:

Në mbështetje të Ligjit Nr.9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"; krijojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "Omni Power" SH.P.K., e cila do të ketë objekt veprimtarie:

1. Ndërmjetësimi dhe marketing kombëtar dhe ndërkombëtar i shoqërisë në lidhje me qarkullimin e mallrave të ndryshëm pa kufizim ndërmjet palëve të treta, për pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe çdo gjë tjetër që ka lidhje me sa më sipër. Dhënia e konsulencës dhe shërbimeve ndaj shoqërive, institucioneve publike dhe private. Në veçanti konsulencë ligjore, fiskale, ekonomike, financiare, strategji industriale dhe çështje që i bashkëlidhen (duke përfshirë ristrukturimin dhe riorganizimin e shoqërive/ ndërrmarjeve), gjithashtu me shërbime konsulence në lidhje me aleancat, joint venture, bashkimet, nadrjet, përqëndrimet, blerja e shoqërive, pjesmarrje aksionere ne shoqëri ose dege shoqërish dhe në punë të tjera te jashtëzakonshme financiare, duke bërë studime dhe analiza tregu, përpunim të planeve industriale, kërkimin e partnerëve strategjikë, organizimin e takimeve, konferencave dhe gjithçka është e nevojshme me qëllim zhvillimin e këtyre shërbimeve të konsulencës. Ngritja e një qendre të të dhënave përmes perdorimit të pajisjeve elektronike dhe teknologji të përparuar në përpunimin automatik të të dhënave kontabël dhe fiskale, listën e pagave dhe të kontriboteve, që do të përdoret si për aktivitetet e saj dhe si një aktivitet për të tretët. Shërbimi i asistencës përfshin të gjitha detyrimet tatimore, të planifikimit fiskal, konsulenca financiare dhe kontraktuale për ndihmën në operacionet e jashtëzakonshme, si dhe të kontabilitetit dhe të përpunimit të listës së pagave.
2. Ndërtim të banesave civile, industriale, monumentale, kompletim të impianteve dhe përfundim të tyre; vepra restaurimi; ndërtim të asfaltit; të auroporteve dhe hekurudhave; të galerive; të urave; të digave;vepra speciale të betonuara; punime hekurudhore; punime hidraulike; ujësjellësi; gazsjellësi; vajgursjellësi; mbrojtje dhe sisteme hidraulike; agrare; pyjore; punime detare dhe të portit; impiante të mbarështimit; të pastrimit të ujit të pijshëm; realizimit të impianteve të trajtimittë plehrave; realizimit të impianteve teknologjike dhe speciale për ndërtimin; realizimin e karpenterisë metalike; realizimin e impianteve për për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë; zbulime; eksplorime të nëntruallit; rregullim të tërreneve dhe shpim pusesh. Shoqëria do të kryejë pune për ndarjen në parcela dhe të urbanizimit në përgjithësi,

projektimit, llogaritjeve statike, drejtim punimesh si dhe të veprojë si koordinuese teknike dhe administrative me sipërmarrje të tjera; të tregtojë dhe të prodhojë me shumicë detale të cfarëdo lloj materiali në përgjithësi për ndërtimin; sjelljen e pajisjeve dhe atrecaturave për kantiere; të kruejë blerjen, shitjen, ndërtimin, administrimin dhe shkëmbimin e pasurive të paluajtshme. Ajo mund të kryejë përvec të gjitha veprimeve tregtare, financiare dhe kreditore, të tundshme dhe të patundshme, edhe qiramarrjen nëse është e nevojshme dhe e mundshme për vazhdimin dhe realizimin e qëllimit të shoqërisë. Dhënie ambientesh e objektesh me qira, si pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Blerje- shitje pasuri të paluajtshme. Veprimtari tregtare në fushën e ushqimit social, hoteleri, turizëm, shitje materiale ndërtimi.Import-export dhe tregti me shimcë dhe pakicë i të gjitha mallrave industriale, ushqimore, elektroshtëpiake, mekanike dhe elektromekanike, pajisje telekomunikacioni, automjeteve, pjesë këmbimi për automjete, pajisje elektrike, hidraulike dhe duralumini, pajisje hidrasanitare, prodhime bujqësore e blegtorale, të sinjalistikës rrugore, si dheçdo lloj malli/produkti tjetër të lejuar nga legjislacioni ahqiptar, drejtimi, administrimi dhe shfrytëzimi i supermarketeve dhe hipermarketeve, shitja me pakicë e produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, prodhimi i e produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, transportimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore; drejtimi i aktiviteve të turizmit dhe të tjera, si dhe çdo veprimtari tjetër e ligjshme.

3. Menaxhimi për llogari të vet dhe/ose të të tretëve të rrjeteve ose zinxhirëve të hoteleve, apartamenteve për pushime, restoranteve, bareve dhe snack bareve, picerive, bareve rostiçeri, pastiçerive dhe dyqaneve të bukës, fast food-eve, garni (hotele vetem me shërbim mëngjesi), strehave malore, kamping-jeve, piano bar, diskove, lokaleve të natës, lokaleve argëtuese, sallave të lajrave, diskove pub, rezidencave turistike hotelerish, dhe në përgjithësi ushtrime publike në fushën e shërbimit dhe të sektorit hoteleri –turizëm, të organizuara dhe të lidhura duke përdorur mënyra të tilla si franchising ( praktika të përdorimit të modeleve të sukseshme të biznesit), aleanca strategjikedhe tregtare, filiale (ortakerie), partneritete, sipërmarrje të përbashketa dhe çdo mjet të mundshëm që finalizojnë krijimin e rrjeteve apo grupeve te konpanive në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; Ofrimi i shërbimeve në fushën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, vlerësimin e pasurive të paluajtshme, shërbime konsulence dhe tragtare si she përfaqësim të të tretëve në fushën e pasurive të luajsthme dhe të paluajtshme, ndërmjetesim dhe shitje me pakicë të çdo lloj pasurie të lujsthme dhe të paluajtshme, dhënien me qira apo në përdorim të tyre, investime në fushën e pasrive të paluajtshme në përgjithësi dhe veprimtari ndihmëse të lidhura me të. etj.

Selia e shoqërisë është në adresën: Vlore, Rr."Dhimiter Konomi",ZK 8602, pasuria me nr. 43/561/ND+1-5/1, Vol.75, fq.197 .Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Kohëzgjatja e shoqërisë "Omni Power "shpk është caktuar të jetë pa afat ,

Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është 100 (njeqind) leke. Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga ortakët :

**Ortaku themelues Klaus Çiraku,** i cili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 75 (shtatëdhjetë e pesë) lekë që përfaqëson 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
**Ortaku themelues Eljana Velaj**, e cila zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 25 (njëzet e pesë) lekë që përfaqëson 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.